

Durimi 
në sprov

Titulli i librit:
“Durimi në sprova është prej besimit”

Ligjëroi:
Hoxhë **Lulzim Perçuku**

Kontrolloi:
Hoxhë **Lulzim Perçuku**

Transkriptoi:
Albiona Olluri

Kopertina dhe faqosja:
Agron Hyseni

Qershor, 2024

Çfarë është durimi?

Durimi ndaj caktimeve të Allahut është prej gjërave që plotësojnë teuhidin (veçimin e Allahut me adhurim), ndërsa e kundërta, e mangëson atë. Kjo gjë është prej degëve apo veçorive të besimit. Dhe besimi është besim me zemër, thënie me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë, shtohet me bindje ndaj Allahut dhe mangësohet me bindje ndaj shejtanit.

Durimi gjuhësisht d.m.th: burgosje/lidhje e diçkaje. Ndërsa, në aspektin fetar d.m.th.: burgosje e nefsit në bindje ndaj Allahut dhe në largim prej mëkateve. Qëllimi me durimin është që njeriu ta burgosë nefsën e tij duke e detyruar të veprojë disa

gjëra apo duke e ndaluar prej disa të tjerave. Realiteti i durimit është zbatimi i urdhrave fetarë, largimi prej ndalesave fetare dhe durimi ndaj fatkeqësive gjatë jetës. Durimi është prej adhurimeve më madhështore të cilat njeriu i vepron me zemrën e tij, me gjuhën e tij dhe me gjymtyrët e tij (me të gjitha duhet të tregohet i durueshëm). Të qenët rob adhurues i Allahut nuk realizohet veçse duke u treguar të durueshëm.

Sprovimi i njeriut prej Allahut bëhet përmes:

1. *Fesë së tij*. Allahu thotë në hadith kudsij: **“Ty të kam dërguar si Pejgamber për të të sprovuar dhe për t’i sprovuar të tjerët me ty.”** Kjo provë bëhet përmes urdhrave dhe ndalesave.

2. *Dhe caktimeve (kadereve) të Tij*.

Përderisa Allahu ka vendosur me urtësinë dhe mëshirën e Tij ta sprovojë llojin njerëzor me urdhra, ndalesa dhe fatkeqësi, njëkohësisht ka urdhëruar për durim ndaj tyre, dhe e ka bërë obligim durimin si ngushëllim për ta. Dhe nuk

është ndalur me kaq, por ka premtuar shpërblim të madh për durimtarët. Allahu thotë: **“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë.”** Zumer 10.

Durimi ndahet në tri lloje: 1. *Durimi ndaj urdhrave të Allahut* (duke i kryer edhe pse gjen vështirësi), 2. *Durimi ndaj ndalesave të Tij* (duke u larguar prej tyre), 3. *Durimi ndaj sprovave, fatkeqësive*. Të gjitha këto lloje i përfshin Fjala e Allahut: **“...dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne dhe, që të keqen, e kthejnë me të mirë. Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit: Xheneti i Adnit...”** Rad 22. Dhe: **“(Xheneti është për) ata që kanë duruar...”** Nahl 42.

Durimi nuk arrihet ndryshe veçse me ndihmën e Allahut, **“Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut”** Nahl 127.

Kur njeriu tregohet i durueshëm, kjo është prej niveleve më të forta përmes të cilave arrihet

dashuria ndaj Allahut. Shumë njerëz kur sprovohen humbin durimin. Vetëm durimtarët qëndrojnë të paluhatshtëm para sprovave e fatkeqësive. Një dijetar ka thënë: *"Ai që e do Allahun, nuk i konsideron sprovat e fatkeqësitë që e godasin një gjë të keqe që po i ndodhin. Ai që e do Allahun, nuk i sheh të rënda detyrimet e obligimet me të cilat e ka obliguar Allahu."*

Caktimet e Allahut

Kaderi është ajo që Allahu ka vendosur apo ka gjykuar të ndodhë tek krijesat e Tij. Çdo gjë që ndodh është me kader, nuk ka mundësi të ndodhë diçka pa Caktimin e Tij ngase Ai është i Gjithëdijshtëm. Ai i ka ditur ato që do të ndodhin, i ka shkruar ato dhe i ka bërë kader të ndodhin. Mirëpo, çfarë përfshin kaderi? Kur përmendet kaderi atëherë për qëllim janë dy gjëra:

1. *Ose gjëja e caktuar,*
2. *Ose vepra e Allahut (që e ka caktuar).*

Sa i përket të parës (kur ndodh diçka e padëshiruar), njeriu e ka obligim të durojë, ndërsa të jetë i kënaqur me të është gjë e preferuar. Kurse, sa i përket të dytës, njeriu e ka obligim të jetë i kënaqur dhe të bëjë durim. Shembull: Dikujt i digjet makina, në këtë rast, sa i përket asaj se Allahu e ka bërë kader (e ka caktuar që kjo të ndodhë) atëherë njeriu e ka obligim të jetë i durueshëm dhe të jetë i kënaqur me këtë ngase është vepër e Allahut (kjo është prej të qenët i kënaqur me Allahun si Zot i tij).

Dhe në vijim, ne do të flasim sa i përket llojit të tretë të durimit.

Durimi ndaj sprovave, fatkeqësive

Dijetarët kanë përmendur se durimi ndaj sprovave ka tri nënloje:

1. *Ndalja e zemërimit, me zemër, ndaj kaderit të Allahut.*
2. *Mbajtja e gjuhës prej ankesës tek krijesat, përveçse tek Allahu.*
3. *Ndalja e gjymtyrëve duke mos shfaqur zemërim ndaj kaderit (shqyerja e rrobave, goditja e faqeve etj.).*

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Durimi është dritë (që e ndriçon besimtarin).”** Dhe: **“Askujt nuk i është dhënë dhuratë më e mirë dhe më e gjerë sesa durimi.”** Kjo ngase durimi përfshinë shumicën e fesë.

Ibn Kajjim rahimehullah shpjegon se janë tri gjëra të cilat nëse njeriu i ka atëherë do të jetë i durueshëm gjatë sprovave:

1. *Të dijë shpërblimin e madh për durimin dhe për durimtarët, të jetë i bindur në këtë.*
2. *Të presë lehtësimin, të jetë i bindur në këtë.*

3. *Të numërojnë dhuntitë e të mirat që posedon (janë të shumta, s'mund të numërohen) dhe do të shohë se sprova me të cilën është goditur në krahasim me to është sikur një pikë në oqean, si dhe të kujtojë të mirat e kaluara që ia ka dhënë Allahu.*

Përmendja e argumenteve në këtë temë

Argumenti i parë



Allahu thotë: **“Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me vullnetin e Allahut. Ai ia udhëzon zemrën kujt do që i beson Atij.”** Tegabun 11.

Allahu na tregon këtu se të gjitha sprovat janë me caktimin dhe me vendimin e Tij. Nuk ka mundësi të ndodhë ndryshe një fatkeqësi në këtë botë veçse me Caktimin e Tij. Alkame (dijetar prej tabiinëve) ka thënë: *“Allahu në këtë ajet flet për një njeri i cili goditet nga një fatkeqësi dhe e di se ajo është prej Allahut (nuk hidhërohet), andaj është i kënaqur (me të si Kader i Tij) dhe i dorëzohet kaderit të Tij (ngase e di se është prej Tij).”* Besimtari i mirë nuk thotë: *“Sikur të veproja kështu e ashtu nuk do të isha goditur nga*

kjo gjë!”, ngase e di se çdo gjë që e godet është me kaderin e Allahut. Në këtë mënyrë, atij që ka besimin e saktë, i lehtësohet çështja dhe e ka më të lehtë të ballafaqohet me fatkeqësinë.

-“**kujtdo që i beson Atij**”- që tregohet i durueshëm dhe është i kënaqur me Caktimet e Allahut.

Allahu në këtë ajet sjell kushtin që është *besimi në Allahun* dhe sjell shpërblimin që është *udhëzimi i zemrës*. Dhe si ia udhëzon zemrën? Ai në zemrën e tij i vendos besim, dije, dritë dhe largpamësi, ia udhëzon zemrën të tregohet i durueshëm në fatkeqësinë me të cilën është goditur e të mos hidhërohet me kaderin, ia udhëzon zemrën drejt adhurimeve, do të ndjejë prehje e qetësi në zemër etj. Ka mundësi që Allahu për shkak të durimit që tregon besimtari gjatë fatkeqësive, t’ia zëvendësojë atë që ia ka marrë prej çështjeve të kësaj jete me diçka të ngjashme apo më të mirë. Ndërsa, kush hidhërohet me kaderin dhe tregohet i padurueshëm, atëherë Allahu nuk ia udhëzon

zemrën atij dhe do të mbetet i përhumbur, në brenga e ankth.

Ibën Abbasi për pjesën **“Ai ia udhëzon zemrën kujtdo që i beson Atij”** ka thënë: *“Ia udhëzon drejt bindjes dhe ai e di bindshëm se ajo që e ka goditur nuk ka pasur mundësi të mos e godiste dhe ajo që nuk e ka goditur nuk ka pasur mundësi ta godiste.”*

Besimi në caktimin e Allahut (kader) sjell si rezultat në zemrën e njeriut qetësi, prehje dhe kënaqësi dhe gjithashtu largon prej tij brengat, shqetësimet e pikëllimet. Kjo sepse me këtë bindje e besim, e di se ajo që e ka goditur nuk ka pasur mundësi të mos e godiste (ka qenë e shkruar) dhe ajo që nuk i ka ardhur nuk ka pasur mundësi t'i vinte. Duke pasur këtë bindje, do të ketë qetësi e rehati shpirtërore. Kështu, ai e di se çdo gjë me të cilën është sprovuar (fatkeqësi a mirësi), i ka ardhur prej Atij i Cili është më i Mëshirshëm për të sesa vetja e vet dhe të gjithë njerëzit. Atë që Allahu e ka caktuar për të, është e mirë, më e mira për të, edhe pse nga pamja e jashtme e sheh të

dhimshme, të lodhshme etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Është e çuditshme çështja e besimtarit! E gjithë çështja e tij është e mirë. Kjo nuk i takon askujt përveçse besimtarit. Kur i vjen një e mirë, është falënderues ndaj Allahut dhe kjo është mirë për të. Kur e godet diçka që e dëmton, është durimtar dhe kjo është mirë për të.”**

Besimi është i ndërlidhur me zemrën, ngase kur zemra udhëzohet, atëherë patjetër udhëzohen edhe gjymtyrët e njeriut, siç është hadithi: **“Në trup është një copë mishi, nëse ajo përmirësohet atëherë përmirësohet i tërë trupi e nëse ajo prishet, atëherë prishet i tërë trupi. Vini re, ajo copë mishi është zemra.”**

Dhe caktimi i Allahut kthehet tek *urtësia e Tij*. Urtësia e Tij d.m.th.: vendosja e gjërave në vendin e tyre dhe në përputhje me synimet e lavdishme. Allahu është el Hakim – i Urti. Atij i përket drejtësia absolute dhe i mohohet padrejtësia. Çdo gjë që të ka goditur Allahu e ka ditur atë dhe e ka

caktuar me urtësinë e Tij, ngase në të ka mirësi për ty. Dhe kjo e detyron njeriun të tregohet i durueshëm dhe i kënaqur me Caktimin e Tij. Nëse tregohesh i durueshëm, atëherë do të kesh shpërblime e të mira të shumta (sepse shpërblimi për të mirën është e mira), Allahu do të të shpërblejë në këtë dunja dhe në ahiret.



Argumenti i dytë



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:
“Janë dy vese te njerëzit të cilat i vepronë ata dhe
janë kufër (mohim): të akuzosh tjetrin në
prejardhjen e tij dhe të vajtosh për të vdekurin.”

Muslimi.

-“te njerëzit” te bijtë e Ademit, prej tyre edhe te muslimanët, ngase ka prej muslimanëve të cilët kanë cilësi të xhahiljetit (periudhës para islame), të jobesimtarëve, cilësi të kufrit-mohimit. Mirëpo, nuk do të thotë se kanë dal nga Islami (nëse kanë vepruar këto cilësi). Shejh ibën Tejmije ka thënë: *“Këto dy cilësi janë mohim që qëndrojnë te njerëzit (i vepronë)...mirëpo nuk do të thotë se ai tek i cili ekziston një degë e mohimit të llogaritet se është bërë jobesimtar...”*

-“të akuzosh tjetrin në prejardhjen e tij” d.m.th.: t’ia shash tjetrit prejardhjen (babanë, babagjyshin

etj.), apo sipas një mendimi tjetër të mohosh atësinë e vërtetë të tjetrit (duke i thënë se ti nuk je biri i filanit).

“të vajtosh për të vdekurin”-të shfaqësh hidhërimin e mërzinë siç kanë vepruar njerëzit e xhahiljetit, ata kanë qarë për të vdekurin me zë apo e kanë vajtuar duke ia numëruar të mirat. Kjo është prej mëkateve të mëdha. Kjo tregon për mosdurim me fatkeqësinë që e ka goditur, hidhërohet e zemërohet me caktimin e Allahut.

Kjo e kundërshton durimin e detyruar, i cili është: burgosja e gjymtyrëve duke mos shfaqur hidhërimin (si: shqyerja e rrobave, goditja e kokës, e fytyrës etj.), burgosja e gjuhës duke mos folur fjalë që tregojnë mosdurim dhe hidhërim ndaj kaderit, apo duke mos u ankuar te dikush tjetër ashtu siç i ankohesh Allahut, dhe këtu hyn edhe vajtimi për të vdekurin, gjë e cila është prej degëve të mohimit ngase kundërshton durimin e detyruar gjatë fatkeqësive (p.sh. kur i vdes një i afërm-familjar etj.).

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që njeriu të mos qajë me lot e të mos ndjejë dhembje në zemër.¹ Kjo është e lejuar dhe nuk e kundërshton durimin, si dhe kjo tregon për mëshirën që ke në zemër. Shejhul islam ibën Tejmije ka thënë: *“Qarja (me lot) për të vdekurin, nga aspekti i mëshirës, është gjë e mirë dhe e pëlqyer.*

¹ Dhimbja për familjarin e sëmurë - Të qarët për familjarin e sëmurë apo të vdekur, kjo nuk është e ndaluar. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka qarë kur i ka vdekur djali, Ibrahim, dhe ka thënë: **“Kjo është mëshirë të cilën e ka vendosur Allahu në zemrën e prindit, mirëpo ne themi vetëm atë me të cilën Ai është i kënaqur.”** Duhet thënë vetëm fjalë me të cilat Allahu është i kënaqur (si: Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi). Allahu është Ai i Cili e ka caktuar këtë sprovë dhe Ai është më i Mëshirshëm për familjarin tënd të sëmurë sesa ti. Ai e di pse e ka caktuar këtë gjë për të. Ndoshta kjo sprovë bëhet shkak që ai të hyjë në xhenet. Njeriut i dhimbset prindi kur është i sëmurë sepse kjo është mëshirë që e ka vendosur Allahu në zemrën e tij për të afërmit, mirëpo ajo që ia lehtëson çështjen është kur kujton se kush është Ai i Cili ka caktuar që të sprovohet. Allahu, Ai i Cili është i Gjithëdijshtëm, i Urtë, ka urtësi absolute, Ai e di pse e ka bërë caktim kështu. Dija e Allahut është e pakufishme, Ai është i Mëshirshëm. Nëse do të na jepej mundësia të shohim rezultatin e sprovës dhe se ai është xheneti, atëherë edhe ne do ta zgjidhnim atë sprovë për veten tonë.

Kjo nuk e kundërshton të qenët i kënaqur me caktimin e Allahut."

Nivelet e njerëzve në raport me fatkeqësitë

Kur njerëzit i godet fatkeqësia, ata ndahen në disa nivele, siç shpjegojnë dijetarët:

-Ata që *zemërohen* me Caktimin e Allahut dhe *nuk pajtohen* me të. Kjo ndodh ose me zemër (kjo është prej ndalesave të mëdha dhe mund ta dërgojë njeriun në mohim), ose me gjuhë (lutet që Allahu ta shkatërrojë, ta mallkojë), ose me gjymtyrë (shqyerja e rrobave, goditja e fytyrës, shkulla e flokëve etj.).

-Ata që *durojnë* ndaj Caktimit të Allahut (edhe pse durimi është shumë i hidhur, por fryti i tij është më i ëmbël sesa mjalti). Njeriu kur e godet një gjë, e sheh shumë të rëndë dhe nuk e pëlqen, porse bën durim (i shtyrë nga imani që ka), ngase e di se kjo i sjell fryte të mira në jetën e tij.²

² Besimtari e ka obligim të durojë për sprovat që e godasin. Nëse nuk duron, kjo është mëkat. Mirëpo, sipas mendimit

-Ata që janë *të kënaqur* me Caktimin e Allahut (ky nivel është më i lartë sesa i dyti). Tek të tillët është njëjtë qoftë nëse goditen apo nuk goditen me fatkeqësi (për ta është njëjtë). Ka mundësi të ndihën të pikëlluar gjatë fatkeqësisë. Ata vazhdimisht shëtisin në kaderin e Allahut dhe kudo që Ai i vendos, ata janë të kënaqur.

-Ata që janë *falënderues* ndaj Allahut (ky është niveli më i lartë). Ata kur goditen me një provë e falënderojnë Allahun, janë mirënjohës edhe nëse i godet me fatkeqësi të mëdha, ngase e dinë se sado të jetë e madhe fatkeqësia në këtë dunja, ajo është shumë më e lehtë sesa fatkeqësia në fe, po ashtu e dinë se dënimi i dunjasë është më i lehtë sesa dënimi i ahiretit (e dinë se fatkeqësia është shkak për shlyerjen e mëkateve apo për shtimin e besimit, andaj e falënderojnë Allahun).



më të saktë të dijetarëve, prova që i ndodh, qoftë nëse duron apo nuk duron, ia shlyen mëkatet, e pastaj durimi i tij është shtesë (nëse nuk duron i shkruhet mëkat, e nëse duron i shkruhet shpërblim tjetër).

Argumenti i tretë:



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:
**“Nuk është prej nesh ai i cili godet faqet e tij,
shqyen rrobat e tij dhe thërret (bërtet) me thirrje
të xhahiljetit.”** Buhariu dhe Muslimi.

Qëllimi me fjalën **“Nuk është prej nesh”** është: Ai që vepron këto vepra ka bërë mëkat (ato janë prej mëkateve), është fjalë paralajmëruese e kërcënuese për të mos i vepruar ato. Por, nuk do të thotë se ai ka dal nga Islami. Ndërsa, disa dijetarë thonë se qëllimi i këtyre fjalëve është: Ai nuk është në sunetin (rrugën) tim. Ky hadith na tregon se ai që ka bërë këto vepra ka bërë mëkat të madh apo ka lënë diçka mangët prej obligimeve të fesë.

“ai i cili godet faqet e tij” duke shfaqur zemërimin për atë që e ka goditur, siç kanë vepruar në kohën e xhahiljetit. Ajo që ligjësohet është që njeriu të tregohet i durueshëm, dhe ky veprim (goditja e

faqeve) është e kundërta e kësaj. Edhe nëse njeriu e godet njëren pjesë të fytyrës, apo të kokës, apo të trupit (gjoksit), hyn në këtë hadith.

“shqyen rrobat e tij” qëllimi është shqyerja e jakës së rrobës (pjesa e rrobës përmes së cilës e fut kokën kur e vesh atë), qoftë pak apo deri në fund. Kështu tregon se nuk është duke u treguar i durueshëm ndaj fatkeqësisë me të cilën është goditur dhe me këtë veprim shfaq zemërimin ndaj kaderit.

“thërret (bërtet) me thirrje të xhahiljetit (periudhës para islame)” – kur t’i ndodhë fatkeqësia, si: ia numëron të mirat e bëra të vdekurit, ose lutet kundër vetes me fjalët “O i mjeri unë!”, “U shkatërrofsha!”, “Allahu ma marrtë shpirtin!” dhe lutje të tjera mallkuese apo shkatërruese.

Pastaj kanë ardhur edhe hadithe të tjera në të cilat Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka mallkuar ata që i veprojnë këto gjëra që u përmendën më lartë, siç është hadithi: **“Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka mallkuar atë grua që**

shqyen/grith fytyrën e saj gjatë fatkeqësisë, atë grua që shqyen rrobat e saj dhe atë grua që lutet kundër vetes.” Këtu përfshihen edhe burrat. Njeriu me këto vepra shfaq zemërimin ndaj Zotit, nuk tregon durim, dëmton vetveten, apo shkatërron pasurinë (duke shqyer rrobat e tij, apo thyen gjërat që ka në dorë), apo gënjen duke thënë për të vdekurin se e ka pasur këtë e atë virtyt të mirë pa e pasur atë, apo lutet për shkatërrim ndaj vetes, apo e akuzon Allahun se i ka bërë padrejtësi duke e goditur me atë fatkeqësi apo duke ia marrë të dashurin e tij etj.

Njeriu e ka obligim të largohet prej të gjitha veseve dhe veprave të njerëzve të xhahiljetit.

Pejgamberi saAllahu alejhi ue selem i përmend këto tri vepra ngase zakonisht ndodh kështu: ose godasin faqet, ose shqyejnë rrobat, ose flasin fjalë të xhahiljetit. Ngjashëm me këtë është kur njeriu bën shkatërrim brenda shtëpisë së tij, shembull: thyen enët, hedh ushqimin, thyen telefonin etj. E gjithë kjo hyn në këtë ndalesë që ka ardhur në

hadith. Gjithashtu hyjnë dhe disa të tjera, si: qarja me melodi, rruajtja e flokëve, grithja e fytyrës etj.

Për këtë arsye, ai që braktis durimin dhe shfaq zemërim ndaj kaderit, le të dijë se ka bërë mëkat dhe me këtë ka mangësuar besimin e tij, ngase siç e dimë besimi shtohet me vepra të mira dhe pakësohet me mëkate, dhe këto gjëra janë prej mëkateve të mëdha të cilat ia pakësojnë besimin njeriut.



Argumenti i katërt:



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

“Kur Allahu ia do të mirën robit të Tij, ia shpejton ndëshkimin në këtë jetë. Kur Allahu ia dëshiron të keqën, ia shtyn ndëshkimin (për në ahiret), në mënyrë që në Ditën e Gjykimit kur ta ndëshkojë për gjynahet atëherë ta ndëshkojë plotësisht.” Tirmidhiu dhe të tjerë.

-**“Kur Allahu ia do të mirën robit të Tij”** dhe **“Kur Allahu ia dëshiron të keqën”**- kjo tregon se nganjëherë Allahu ia do të mirën robit të tij e nganjëherë të keqën. Mirëpo, te pjesa **“ia dëshiron të keqën”** nuk është për qëllim *e keqja*, si Caktim dhe Vepër e Allahut, ngase Ai nuk cakton të keqe, Ai cakton çdo gjë me urtësi. Andaj, për një urtësi apo mirësi që fshihet pas saj (sprovës), nga njëri aspekt ajo llogaritet mirësi. Mirëpo, kjo pjesë e hadithit nënkupton: siç e sheh njeriu, në sytë e tij

është e keqe (për qëllim është e vepruara, e keqja që e godet njeriun).

Shenjë që tregon se Allahu e do dikë është kur e sprovon atë, kuptohet kur ai është besimtar i mirë.

-“Kur Allahu ia do të mirën robit të Tij, ia shpejton ndëshkimin në këtë jetë”, d.m.th. ndëshkimin përmes të cilit ndëshkohet keqberësi (ai që vepron mëkate). Ia përshpejton dënimin dhe ndëshkimin sa është në këtë jetë në mënyrë që t’ia shlyejë mëkatet. I dërgon dënime e fatkeqësi që ta pastrojë prej tyre, duke dal pastaj para Allahut i pastër dhe të meritojë xhenetin. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem na tregon përmes këtyre fjalëve se për besimtarin më mirë është që Allahu t’ia përshpejtojë ndëshkimin në këtë jetë sesa t’ia vonojë për ahiret, ngase ndëshkimi në këtë jetë është shumë më i lehtë dhe dikur përfundon (nuk zgjat përgjithmonë), ndërsa ndëshkimi në ahiret është shumë i ashpër.

Njëri prej dijetarëve këtë hadith e ka shpjeguar:
“Allahu ia përshpejton dënimin në këtë dunja duke i

dërguar bela, fatkeqësi e sprova të ndryshme, si ndëshkim për shkak se e ka lëshuar veten në mëkate dhe është mbushur me to. Kështu, besimtari del prej kësaj dunjaje pa mëkate mbi supe (i shlyhen sa është në këtë jetë). Ndërsa të kundërtit (atij që ia do të keqen) ia shtyn dënimin për ahiret. Me personin të cilit ia përshpejton dënimin duke qenë në këtë dunja, Allahu është sjell me një butësi dhe mëshirë shumë të madhe, ngase kush merret në llogari për shkak të mëkateve të tij sa është në këtë dunja (i shpejtohet dënimi sa është në këtë jetë), atij do t'i lehtësohet ndëshkimi në ahiret..." Në këtë kuptim janë hadithet: **"Allahu vazhdimisht i dërgon fatkeqësi robit të Tij derisa të ecë mbi tokë pa mëkate (pastrohet prej tyre)",** dhe: **"Fatkeqësitë vazhdimisht do ta godasin besimtarin dhe besimtaren, në trup, në pasuri, në fëmijë, saqë kur të takojë Allahun nuk do t'i mbetet asnjë mëkat (dhe kësisoj nuk do të ndëshkohet)."**

Janë edhe disa mënyra të tjera më parësore e më të mira përmes të cilave shlyhen mëkatet, siç është *falja e mëkateve prej Allahut.*

Pastaj, ndëshkimet që vijnë prej Allahut janë disa lloje, prej tyre:

*-Në aspektin fetar, sprova në fe - ky është dënimi më i madh. Kështu sepse kur njeriu ndëshkohet në trupin e tij (shëndet) ka mundësi të kthjellohet dhe të kthehet tek Allahu me pendim, ndërsa kur ndëshkohet me sprovën në fe, atëherë vetëm ai të cilit Allahu i ka dhënë sukses mund ta vërejë këtë (shumë njerëz nuk mund ta vërejnë/hetojnë këtë). Prej sprovës në fe është: kur mëkati të duket gjë e lehtë në shikimin tënd, apo kur lë obligimet dhe kjo të duket gjë e lehtë, apo nuk tregon xhelozë kur shkelen ndalesat, apo kur nuk urdhëron në të mirë e nuk ndalon nga e keqja etj. Këto janë sprova në fe (për shkak të mëkateve të bëra) të cilat njerëzit nuk i vërejnë. Sprova në fe është nëse sprovohesh në dy forma: *me dyshime* apo *me epshe*. Te dyshimet hyjnë edhe bidatet. Nuk ka njeri pa gabime e pa mëkate dhe që nuk e pason epshin nganjëherë, mirëpo qëllimi është kur kjo gjë është e zakonshme te personi ose që mbizotëron tek ai (më shumë i pason sesa që i kundërshton). Devijimi, dyshimet,*

rënia në bidate, ndjekja e sekteve pasi që ke qenë i udhëzuar në sunet, të gjitha këto janë sprovë në fe.

-Në trup, me sëmundje.

-Në familje, me sëmundjen e njërit pjesëtar të familjes, apo me humbjen e tij etj.

-Në pasuri, me pakësimin e pasurisë apo me humbjen e saj.

Shejhul islam ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Fatkeqësitë janë mirësi, sepse shlyejnë mëkatet, sjellin rezultate të tjera madhore... Është e njohur se mirësia më e madhe për besimtarin është kur Allahu ia shlyen mëkatet. Edhe nëse personi është mëkatari më i madh por që Allahu i dërgon fatkeqësi, atëherë patjetër përmes tyre do t’ia shlyejë mëkatet. Në përgjithësi sa i përket krijesave, fatkeqësitë janë mëshirë dhe dhunti për to, përveç rastit kur dikush për shkak të fatkeqësisë zhytet më thellë në mëkate më të mëdha sesa që ka bërë më herët... Ka prej njerëzve i cili kur sprovohet me varfëri, apo me sëmundje, apo me uri, zemërohet e hidhërohet, në zemrën e tij lindin sëmundjet e saj, apo e shfaq haptazi mohimin, apo lë disa obligime dhe vepron disa ndalesa. Kjo dëmton rëndë fenë e tij. Për*

të më mirë është që të mos sprovohet, sa i përket pasojave apo veprave të tij që dalin prej provës, e jo vetë fatkeqësisë (ngase në çdo gjë që Allahu cakton ka urtësi). Gjithashtu dhe e kundërta, kur Allahu e godet dikë me fatkeqësi dhe tregohet i durueshëm, atëherë kjo për të është mirësi në fe, prandaj kjo mirësi në vetvete është vepër e Zotit dhe gjithashtu është mëshirë për krijesën e Tij, Ai duhet të falënderohet e lavdërohet për këtë. E nëse njeriu shton edhe adhurimet (përveç që ka durim) atëherë kjo është mirësi tjetër e dytë për të... Mirësi tjetër është ngritja e shkallëve/gradëve, dhe kjo është prej mirësive më të mëdha. Andaj, është obligim që besimtari të tregohet i durueshëm ndaj çdo sprove. Ai që tregohet i durueshëm me durimin obligativ i arrin të gjitha këto të mira.”

-“**Kur ia dëshiron të keqën, ia shtyn ndëshkimin (për në ahiret)**”- Ndodh të shohim ndokënd të bëjë mëkate haptazi, si: imoralitet apo të tjera, dhe nuk goditet nga ndonjë e keqe, por bën një jetë të kënaqshme, me shëndet etj. Mirëpo, kjo është shenjë e keqe për të, ngase Ai ia vonon ndëshkimin për ahiret, ku ndëshkimi është më i madh. Nëse

njeriu është në mirëqenie dhe duke jetuar jetë të mirë, kjo nuk është argument se Allahu është i kënaqur me të, përkundrazi, ka mundësi që në mënyrë të përshkallëzuar, graduale, ta dërgojë drejt dënimit.

–“në mënyrë që në Ditën e Gjykimit t’ia japë ndëshkimin e plotë (për gjynahet e bëra)”– kjo është e keqja e shtyrjes së dënimit për në ahiret. Një dijetar i njohur nga selefi el Azizi, ka thënë: *“Kështu na tregon se Allahu nuk e ndëshkon në këtë dunja për mëkatet e tij, në mënyrë që kur të dalë para Tij të dalë i mbushur me mëkate, andaj dhe të ndëshkohet me ndëshkim të plotë siç e meriton.”*

Allahu nuk e ka bërë këtë dunja vend përmes të cilit i shpërblen robërit e Tij të mirë dhe nuk e ka bërë këtë dunja vend përmes të cilit i ndëshkon armiqtë e Tij, por këto i ka shtyrë për në ahiret (të devotshmit në xhenet, ndërsa të këqijtë në xhehenem).

Ky hadith është ngushëllim për besimtarin të cilin e kanë goditur fatkeqësitë e sprovat e ndryshme,

që ai të mos e humbet shpresën, të mos pikëllohet e të mos zemërohet me sprovën, ngase ka mundësi që ajo të jetë e mirë për të dhe dënimi i dunjasë është shumë më i lehtë, andaj duhet ta falënderojë Allahun që nuk ia ka shtyrë dënimin për në ahiret ku dënimi është shumë më i rëndë.

Ky hadith na sqaron urtësinë e Allahut, pra kur goditemi me fatkeqësi dhe e kujtojmë këtë që thamë, atëherë do të na shtohet durimi gjatë sprovës dhe do të jemi të kënaqur me Caktimin e Tij.³

³ Arsyeja pse njerëzit bien në depresion për shkak të sprovave, është besimi i dobët, bindja e dobët, gjithashtu mosnjohja e Allahut, mosrealizimi i teuhidit dhe mosnjohja e realitetit të kësaj jete. Besimtari duhet të dijë se në këtë botë ka ardhur për t'u sprovuar e në të cilën nuk ka jetë ideale. Jeta ideale është në xhenet. Kjo botë është provim për ne. Prej momentit kur lind e deri kur të vdesë, vazhdimisht i ekspozohet sprovave të ndryshme, ngase ky është realiteti i kësaj bote. Allahu ka dashur të na provojë, e pastaj ai që meriton xhenetin ta fitojë atë dhe ai që meriton xhehenemin ta fitojë atë. Krijesa më e dashur e Allahut, Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, ka qenë njeriu më i sprovuar. Me gjithë sprovat që ka pasur, si: varfëri, frikë, luftëra, helmim, dëbim nga vendi, vdekje të fëmijëve etj., gjithmonë ka qenë i buzëqeshur. Sahabët kanë thënë: "*Sa herë e kam takuar ka*

Nëse dikush thotë: “Unë nuk kam bërë mëkate, por prapë më ndodhin fatkeqësi”, atëherë themi: Nëse ekziston një njeri i tillë, kjo është nga aspekti se Allahu do të sprovtojë durimin e tij dhe të ngritë gradat e tij në xhenet nëse tregohet i durueshëm dhe shpreson në shpërblimin e Tij. Megjithatë, njeriu nuk duhet ta shohë veten me këtë sy (se është pa mëkate), ngase ky është vetëlavdërim dhe nuk lejohet.

Kur njeriu sprovohet me një fatkeqësi, duhet të llogarisë se kjo është për shkak të mëkateve të tij dhe Allahu po ia shlyen ato përmes asaj fatkeqësie dhe po ia shpejton dënimin qysh në këtë dunja, gjë

buzëqeshur.” Këto sprova nuk kanë qenë shkak që ai të dëshpërohet apo të heqë dorë nga misioni i tij, përkundrazi, as nuk janë vërejtur në fytyrën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Sot, prej shkaqeve pse njerëzit vuajnë për shkak të depresionit, apo dëshpërimit, apo stresit, është se nuk e kanë realizuar teuhidin apo kanë mangësi në këtë. Sa më shumë që e realizon teuhidin aq më të lehta i bëhen sprovat e kësaj bote. Sa më shumë që është munduar të mësojë dhe realizojë teuhidin gjatë mirëqenies, aq më lehtë do ta ketë kur është në sprova e fatkeqësi.

kjo e cila është më mirë për të sesa t'ia shtyjë për në ahiret.

Ka mundësi që fatkeqësitë për dikë të jenë më shumë sesa mëkatet e të metat e tij, atëherë në këtë rast Allahu dëshiron t'ia mundësojë durimin dhe ta ngritë në shkallë të larta të durimtarëve. Durimi në raport me besimin është sikur koka në raport me trupin. A qëndron koka pa trup? Jo. Ashtu dhe besimi nuk qëndron pa durim.

Njeriu duhet të ketë shpresë tek Allahu dhe mendim të mirë ndaj çdo kaderi që e godet. Edhe nëse shpirti i tij nuk e do, ajo është më e dobishme për të, siç ka thënë Allahu: **“Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** Bekare 216.



Argumenti i pestë:



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:
“Shpërblimi i madh vjen me sprovën e madhe.
Vërtet, kur Allahu e do një popull e sprovon me
fatkeqësi. Ai që ndahet i kënaqur, atij i takon
kënaqësia e ai që nuk ndahet i kënaqur
(zemërohet), atij i takon zemërimi.” Tirmidhiu.

Hadithi na tregon se shpërblimi vjen krahas fatkeqësisë së madhe, sa më e madhe të jetë ajo, edhe shpërblimi është më i madh, mirëpo me kusht që i sprovuari të tregohet i durueshëm dhe të jetë i kënaqur me Caktimin e Allahut. Kështu ai do të shpërblehet në të dy botët. Allahu thotë: “**Ai ia udhëzon zemrën kujt do që i beson Atij.**” Tegabun 11. Konteksti i ajetit është “kujt do që tregohet i durueshëm”. Pra, ai e di se sprovat janë prej Allahut, beson bindshëm në këtë, andaj dhe Allahu ia udhëzon zemrën. E prej udhëzimit vijnë

të gjitha të mirat, në këtë botë dhe tjetrën. Allahu e shpërblen punëmirin me të mira dhe nuk ka mundësi t'i japë shpërblim më pak sesa që e meriton.

Nuk është i njëjtë shpërblimi i atij i cili thumbohet nga një gjemb me të atij të cilit i thyhet koci (ashti), pa dyshim se kjo e dyta është sprovë më e madhe. Andaj, nëse tregohet i durueshëm, edhe shpërblimi për të do të jetë më i madh. Kjo tregon për përsosmërinë e drejtësisë së Allahut, i Cili nuk i bën padrejtësi askujt.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nëse Allahu e ka shkruar për robin e tij të jetë në një shkallë/pozitë të lartë në xhenet, por që nuk e arrin me veprat e tij, atëherë i dërgon sprova në trupin e tij, apo në fëmijët e tij, apo në pasurinë e tij, pastaj ia mundëson të tregohet i durueshëm, derisa ta arrijë atë pozitë.”** Buhariu dhe Ebu Daudi. Pra, kështu kuptojmë se **“Shpërblimi i madh vjen me sprovën e madhe”,**

do të thotë atëherë kur njeriu tregohet i durueshëm dhe shpreson në shpërblimin e Allahut.

-**“Vërtet, kur Allahu e do një popull e sprovon me fatkeqësi”**- e sprovon duke caktuar për ta fatkeqësi, si: sëmundje, humbje të një familjari, apo të familjes, apo pakësim të pasurisë, apo vështirësi të shumta gjatë jetës etj. Dikujt prej njerëzve i vijnë fatkeqësitë vazhdimisht, kurrë nuk i ndalen, dhe nëse ai është besimtar i mirë dhe tregohet i durueshëm, atëherë (ky sprovim i vazhdueshëm) është shenjë e mirë për të ngase kur Allahu e do dikë, apo i do disa njerëz, apo një popull, atëherë i sprovon.

Kuptimi i hadithit është se nëse Allahu nuk e sprovon personin, atëherë kjo ka mundësi të mos jetë shenjë e mirë për të (është rrezik të kalojë në ahiret i mbushur me mëkate dhe të dënohet për to).

Përveç këtyre sprovave, janë edhe sprovat në rrugë të Allahut. Allahu thotë: **“Në të vërtetë, Ne ta kemi shpallur Kuranin ty hap pas hapi. Prandaj ki durim për vendimin e Zotit tënd...”** Insan 23-

24. Këtu Allahu tregon se ajo që i ka ardhur Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem është nimet-mirësi, mirëpo kërkohet durim, prej tij dhe prej pasueseve të tij, durim në kryerjen e adhurimeve dhe në largimin prej ndalesave. Andaj, prej llojeve të durimit me të cilin duhet të pajiset muslimani është edhe durimi në largimin prej ndalesave.

Në këtë hadith (të temës) tregohet se sprovat i godasin ata njerëz të cilët i do Allahu. Përderisa njerëzit të cilët Allahu i ka dashur më së shumti kanë qenë Pejgamberët, andaj dhe i ka sprovuar me sprovat më të mëdha. Kjo me qëllim që Allahu t'ua japë shpërblimin më të madh dhe të jenë model për të tjerët (shembuj për durimin).⁴

⁴ Një qëllim tjetër pse Allahu i ka sprovuar Pejgamberët është të dijë njerëzimi se ata thjeshtë janë njerëz, janë krijesa, janë sikurse pjesa tjetër e njerëzve të cilët i godasin sprovat e fatkeqësitë. Andaj, nuk lejohet të adhurohen krahas Allahut, por vetëm Allahu duhet të adhurohet. Kur njeriu e di se Pejgamberët apo të tjerët, goditen me fatkeqësi, dhe se askush nuk ka mundësi t'ia largojë ato përveç Allahut, atëherë do ta dijë se ata përderisa për veten e tyre nuk mund

Mund të lindë pyetja: “Si ka mundësi që Allahu dikë edhe ta dojë edhe t’i dërgojë fatkeqësi?” Dhe kësaj pyetje më së miri i është përgjigjur ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) duke thënë se Allahu i sprovon sepse:

-dëshiron që t’i pastrojë përmes tyre prej mëkateve,⁵

-besimtari sa herë që goditet me fatkeqësi ai i shton veprat e mira⁶ dhe përmes tyre i shtohen shkallët në xhenet,

të zotërojnë dëmin e dobinë, po ashtu as të tjerëve nuk munden t’ua largojnë të këqijat apo t’iu sjellin të mira.

⁵ Çdo sprovë që na godet është për shkak të asaj që e kemi vepruar prej mëkateve. Nuk është fjala vetëm për mëkatet e jashtme, si: shikimi, gjuha etj. Por shpesh herë njeriu ka edhe mëkate të brendshme, si: mendimi i keq ndaj Allahut, mos mbështetja siç duhet tek Ai, mos durimi me zemër (por veç me gjuhë) etj. Të gjitha kanë pasoja. Allahu, shumë prej mëkateve që bëjmë, na fal dhe nuk na dënon për to. Sikur të na ndëshkonte për të gjitha mëkatet që bëjmë atëherë asnjë krijesë nuk do të mbeste në tokë. E për disa prej mëkateve na sprovon ose na dërgon fatkeqësi, që të na shlyejë ato, në mënyrë që kur të dalim para Allahut të dalim pa mëkate. Dijetarët e selefit kanë thënë: “Nëse nuk do të na sprovonte Allahu në këtë botë, do të dilnim të falimentuar në Ditën e Gjykimit.”

- këto sprova e shtyjnë besimtarin e mirë të kthehet me pendim të sinqertë tek Allahu,

-dhe e shtyjnë të shtojë lutjen me përgjërim tek Allahu.

Dhe thotë: “Përderisa këto dhunti kaq të mëdha vijnë si rezultat i fatkeqësive, atëherë njerëzit më parësor për t’i merituar ato janë të dashurit e Allahut. Kur u vijnë këto mirësi e kanë për detyrë ta falënderojnë Atë (dhe ky është nivel i lartë).” Kështu e kuptuam se pse Allahu i sprovon të dashurit e Tij, ngase në sprova përfshihen mirësitë më madhështore të cilat Allahu ia jep robët të Tij.

-“**Ai që ndahet i kënaqur, atij i takon kënaqësia**”- i takon kënaqësia e Allahut. Ky është shpërblim i madh për njeriun, një mirësi e madhe. Shpërblim tjetër është se Allahu i bën edhe të tjerët të jenë të kënaqur me të (kur Ai është i kënaqur me të).

⁶ Kur besimtarit i vjen sprova prej Allahut, ai del prej saj më mirë sesa që ishte para saj, tani shton veprat e mira. Ndërsa, ai që ka besim të dobët apo hipokriti, pas sprovës kanë gjendje më të keqe sesa që kishin para saj.

-“**Ai që ndahet i kënaqur**”- Qëllimi i kënaqjes me fatkeqësinë (kur i ndodh ajo) është si Caktim i Allahut, *si Vepër e Tij*, dhe kjo është obligim, të mos e kundërshtojë atë, të mos hidhërohet e të mos e urrejë atë.

Kur njeriu ndjen dhimbje në trupin e tij kjo nuk e kundërshton të kënaqurit me Caktimin e Allahut. Shumë njerëz rënkojnë për shkak të vështirësisë së sëmundjes, mirëpo ndërkohë zemrat e tyre janë të mbushura me kënaqësi ndaj Allahut. Nëse dikush është i kënaqur me Caktimin e Allahut kjo nuk do të thotë që ai të mos ndjejë dhimbje.

-“**...e ai që nuk ndahet i kënaqur (zemërohet), atij i takon zemërimi**”- i takon zemërimi i Allahut, atij që zemërohet me sprovat si Caktim i Allahut, si *Vepër e Tij*, e urren Caktimin e Tij. Kur njeriu është i zemëruar me Caktimin e Allahut apo e urren, kjo është prej mëkateve më të mëdha. Ndërsa, të jesh i kënaqur me Caktimin e Allahut kur ai të godet ty (*si e vepruar, e gjykuar dhe e ndodhur tek ti*), kjo është e pëlqyer.

Besimtari duhet që çështjen e tij t'ia dorëzojë Allahut, se Ai e di pse e ka caktuar një gjë për të. Në të fshihen urtësi dhe Allahu ka dashur të tregojë mëshirë për të. Kështu duhet të ketë mendim të mirë për Allahun, pastaj të shpresojë në shpërblimin e Tij. Nëse gjendja e besimtarit është e këtyllë, atëherë kjo do t'i sjellë rehati dhe prehje shpirtërore. Ndërsa, kur njeriu zemërohet me caktimin e Allahut dhe ka dyshime se a ka urtësi aty apo jo, atëherë atë do ta shoqërojnë brengat e ankthet dhe nuk do të ketë rehati shpirtërore.

Nëse njeriu goditet me sprova e fatkeqësi nga të gjitha anët, si provim për të, duhet të bëjë durim dhe të kërkojë ndihmën e Allahut. Të mos mjaftohet vetëm me durimin. Kur Jakubi alejhi ue selem e ka kuptuar se çfarë kanë vepruar bijtë e tij me Jusufin alejhi ue selem, ka thënë: **“Por, durim! Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju”**. Jusuf, ajeti 18.



Përmbajtje:

Çfarë është durimi?	3
Caktimet e Allahut.....	6
Durimi ndaj sprovave, fatkeqësive.....	8
Përmendja e argumenteve në këtë temë.....	10